



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

CN.nr.121/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Zenel Leku, kryetar, Muhamet Rexha dhe Nenad Lazic, anëtarë, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit K.E. K Sh.a., me seli në P., kundër debitorit D.P.H “S.C”, me seli në P,”, .., duke vendosur lidhur me propozimin për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm, përkitazi me konfliktin e kompetencës, në seancën e kolegjit të mbajtur më 29.02.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

Për të gjykuar në këtë çështje juridike kompetente në pikëpamje lëndore është Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, të cilës shkresat e lëndës i dërgohen në kompetencë të mëtejme.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit K. E.K Sh.a., ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit D.P.H “S. C”, për ekzekutimin e borxhit në lartësi prej 11,762.60 €.

Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, me aktvendimin E.nr.677/2011 të datës 19.01.2023, në pikën I të dispozitivit është shpallur jo kompetente në pikëpamje lëndore, për të vendosur në këtë çështje juridike, ndërsa në pikën II të dispozitivit është vendosur që pasi që ky aktvendim të merr formë të prerë, lënda i dërgohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, Dhomave të Shkallës së Parë.

Gjykata Komerciale e Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike me aktvendimin KPPP.nr.292/23 të datës 29.01.2024, në pikën I të dispozitivit ka vendosur që të hapë konflikt kompetence në mes të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, për të vendosur në çështjen juridike përmbarimore në mes të kreditorit Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a., ka lejuar përmbarimin ndaj debitorit D.P.H “S.C”. Në pikën II të dispozitivit është vendosur që për të vendosur lidhur më konfliktin e kompetencës lënda i dërgohet Gjykatës Supreme të Kosovës.

Gjykata Supreme e Kosovës, ka vlerësuar se në këtë rast kemi të bëjmë me konfliktin e kompetencës midis gjykatave të ndryshme të cilin e zgjidh Gjykata Supreme e Kosovës, bazuar në nenin 25.2 të LPK-së dhe nenin 13 pika 7 të Ligjit Nr.08/L-015 Për Gjykatën Komerciale.

Nga shkresat e lëndës rezulton se kreditori, Korporata Energjetike e Kosovës Sh.a., me seli në Prizren, më datë 12.10.2011 ka parashtruar propozim për ekzekutim në ish Gjykatën Komunale në Suharekë, tani Degë e Gjykatës Themelore në Prizren, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori D.P.H “S.C”, me seli në P., që t’ia paguaj shumën prej 11,762.60 €. Gjykata ka lejuar propozimin për përmbarim të paraqitur nga kreditori, ndërsa me aktvendimin E.nr.677/2011 të datës 19.01.2023, është shpallur jokompetente në pikëpamje lëndore dhe lëndën ia ka dërguar Gjykatës Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, e pastaj kjo gjykatë lëndën ia ka dërguar Gjykatës Komerciale të Kosovës për vendosje.

Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në këtë çështje juridike me kompetencë lëndore për të gjykuar është Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, për këto arsye:

Me nenin 1 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon procedurën përmes së cilës Gjykatat dhe përmbaruesit privat përcaktojnë dhe zbatojnë përmbarimin në bazë të dokumenteve përmbarues dhe dokumenteve të besueshme, përveç nëse me ligj të veçantë parashihet ndryshe.”* Me nenin 12 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatat nr.06/L-054, i shpallur në Gazetën Zyrtare nr. 22, datë 18 dhjetor 2018, parashihet që: *“Gjykatat themelore janë kompetente për të gjykuar në shkallë të parë të gjitha çështjet, përpos nëse me ligj parashihet ndryshe”*. Me nenin 13 paragrafi 1 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, përcaktohet se: *“Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, dhe ka juridiksion ekskluziv për të gjykuar, në Dhomat e Shkallës së*

Parë dhe Dhomat e Shkallës së Dytë: 1.1. kontestet ndërmjet shoqërive tregtare vendore dhe të huaja, si dhe kontestet ndërmjet personave juridikë publikë dhe privat, në lidhje me çështjet e ndërsjella tregtare dhe çështje tjera mes tyre, dhe 1.2. të gjitha mjetet juridike, siç përcaktohet me ligjin e aplikueshëm për procedurën përbarimore, për çështje brenda kompetencës të kësaj gjykate”.

Gjykata Supreme vlerëson se në këtë rast me kompetencë lëndore për të vendosur në këtë çështje juridike-përbarimore është Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, për faktin se palët në këtë çështje përbarimore kur është lejuar përbarimi dhe lënda ka qenë në Gjykatën Themelore në Prizren, Dega në Suharekë nuk kanë ushtruar ndonjë mjet juridik kundër vendimit për lejimin e përbarimit, ndërsa kreditori nuk ka kërkuar që lënda të kaloj te përbaruesi privat ashtu siç është përcaktuar me nenin 397 të LPP-së, andaj Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë, mbi bazën e këtyre rrethanave nuk ka mundur të shpallet jo kompetente në pikëpamje lëndore por është dashur të vazhdoj në trajtimin e rastit.

Nëse ndonjëra nga palët do të paraqiste ndonjë mjet juridik në këtë çështje përbarimore, ndërsa çështja është në kompetencë të Gjykatës Komerciale, kjo gjykatë do të kishte kompetencë lëndore që të vendosë për të gjitha mjetet juridike, ashtu siç është përcaktuar me LPP dhe nenin 13 paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të shkesave të lëndës e bazuar në dispozitat e lartcekura, gjeti se gjykatë me kompetencë lëndore për të vendosur sipas propozimit për përbarim është Gjykata Themelore në Prizren, Dega në Suharekë.

Nga sa u tha më lart, e në kuptim të dispozitës së nenit 25.2 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

CN.nr.121/2024, datë 29.02.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari
Zenel Leku